



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror
Komisioni për të Drejta, Interesa të Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, 21. 09. 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala nr. N-302

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Sanije Alijaj, nënkryetare e parë e Komisionit, Mufera Shinik, Enis Kervan, Numan Baliq, Rexhep Hoti, Zylfi Merxha, Sadik Idriz, Hafize Hajdini, Dragisha Miriq, Hetem Arifi dhe Xhevdet Neziraj, anëtar.

Munguan: Petar Miletqi, kryetar dhe, Murselj Haljilji, anëtar.

Pjesëmarrës të tjerë: vëzhguesi i OSBE- së, përfaqësuesit e mediave nga Kuvendit të Kosovës.

Nga Personeli Mbështetës i Komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi: Sanije Alijaj, Zëvendëskryetare e parë e Komisionit,

Në këtë mbledhje është propozuar dhe miratuar ky:

R e n d d i t e

Takimi me ministrin e Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, Sasha Rashiq, me Komisionin për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim në temën:
“Lloji dhe realizimi i projekteve të dedikuara komuniteteve për vitin 2010”

Pyetjet dhe sugjectionet

Sanije Alijaj, nënkryetare në fjalën hyrëse së pari përshëndeti pjesëmarrjen e ministrit lidhur me çështjet që adresohen dhe i takojnë komuniteteve, në mënyrë që të shihet realiteti, dhe njëherit të plasohet zëri jonë në ministrinë, të cilat në koordinim me pushtetin lokal të krijojnë klimë për jetë më të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Gjithashtu akceptoi kompetencat e Komisionit ndaj resorëve të Ministrisë dhe fushëveprimeve nga përgjegjësitë e saj për shqyrtimin e çështjeve të caktuara, të cilat lidhen me shkallën e realizimit dhe llojet e projekteve të dedikuara për komunitete. Në këtë kontekst akceptoi se kjo Ministria është një ndër ministrinë më të rëndësishme, kur bëhet fjalë për çështjen e komuniteteve, kur është çështja për kthimin, implementimin e ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve dhe përfaqësuesve të tyre në Republikën e Kosovës, dhe krejt asaj që i takon realizimit të interesave të caktuara të komuniteteve me qëllim të grumbullimit të të dhënave të sakta dhe informatave për llojet dhe realizimin e projekteve të dedikuara për komunitete për vitin 2010. Akcept të posaçëm i dha kryesuesja për qëllimin kryesor të takimit, gjegjësisht lidhshmërisë së bashkëpunimit dhe koordinimit në mënyrë që atë që Ministria planifikon mund edhe të realizohet, ndërsa Kuvendi, si trup ligjvënës, bashkërisht përgjigjet. Në këtë drejtim ajo shprehu interesimin e saj personal rreth çështjeve që Ministria për Komunitete dhe Kthim ka ndikim dhe a e realizon bashkëpunimin për miratimin e projekteve për komunitete të caktuara, e posaçërisht për komunitetin ashkali në fshatin Dubravë, Kuvendi Komunal Ferizaj. Cilët janë faktorët që ndikuan për tërheqjen e projektit? Cili është numri i përgjithshëm i realizimit të projekteve? Cilat projekte presin për t'u realizuar dhe sa janë të planifikuara për vitin e ardhshëm? Në këtë drejtim i ftoj anëtarët e tjerë të Komisionit që të marrin pjesë në diskutime dhe të mbrojnë mendimet dhe sugjerimet nga aspekti i projekteve, të cilat janë të dedikuara për komunitete.

Hafize Hajdini – Tha se kërkesa për takim me ministrin është shumë e arsyeshme, në mënyrë që bashkërisht të bisedohet dhe ndihmohen të gjitha komunitetet. Posaçërisht potencoj çështjen e rëndë të komunitetit ashkali duke kërkuar informatë dhe shënime të mjaftueshme, se a ka Ministria buxhet të mjaftueshëm dhe mjete për projektin, gjegjësisht për ndërtimin e 44 shtëpive në fshatin Dubravë, a ekziston mundësia për fillimin e ndërtimit të këtyre shtëpive dhe a është i kompletuar i tërë dokumentacioni? Gjithashtu u ndërlidh edhe me problemet që lidhen me planin dhe strukturën të shfrytëzuesve dhe të asistencës sociale dhe kërkoi sqarim dhe shkakun e ndërrimit dhe restriksionit të numrit të shfrytëzuesve të skemës së ndihmës sociale të familjeve të rrezikuara nga radhët e ashkalive kur dihet gjendja në terren.

Xhevdet Neziraj – U drejtua me fjalët se kërkesa për takim me ministrin është shumë e arsyeshme, në mënyrë që t'i drejtohem dhe të bisedojmë për ndihmën e komuniteteve. Si sugjestion dhe apel theksoi se Komisioni parlamentar dhe Ministria për Komunitete duhet të mundohen që në periudhat e ardhshme të realizojnë bashkëpunim të ndërsjellë për të gjitha çështjet nga kompetencat gjegjëse, në mënyrë që në periudhën e ardhshme të kemi një koordinim më të mirë në mes të Ministrisë dhe këtij Komisioni. Sa i përket ndërrimit të mendimeve të përbashkëta në mënyrë që komuniteteve në Kosovë t'ju ndihmohet. Pastaj shkurtimisht u përqendrua në mandatin 3 vjeçar për buxhetin e

Ministrisë nga gjithsej 24 milionë euro dhe tha se nga ndarja e mjeteve buxhetore nëpër komuna për komunitetin egjiptian është ndarë shumë pak.

Sa i përket çështjeve të bashkëpunimit ndërmjet resorit të Ministrisë dhe organizatës së UNDP- së dhe mjeteve financiare të organizatave ndërkombëtare, theksoi se ka argumente të mjaftueshme që dëshmojnë për keqpërdorime të ndryshme dhe menaxhim të dobët në fushën e ndërtimit dhe se janë ndërtuar shtëpi të të kthyerve, të cilët nuk kishin nevojë. Diçka e tillë është e pa pranueshme, sepse ato nuk janë të ftuara të caktojnë prioritete. Gjithashtu tha se Ministria ka për obligim të monitorojë implementimin e ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve sponsorë i të cilit është dhe nuk e cenon të njëjtin nga aspekti i strukturës, procedurës për punësim në sipërmarrjet shoqërore dhe shërbime të tjera. Në këtë drejtim Ministria duhet ta forcojë bashkëpunimin me zyrtarë lokale për komunitete nëpër komuna, të cilat me sukses do të angazhohen sa i përket bashkëpunimit, vendimmarrjes, pjesëmarrjes dhe krijimit të politikave të caktuara që i takojnë të gjitha komuniteteve.

Numan Baliq – Theksoi se ekzistojnë shkaqe të ndryshme për mos kënaqësi sa i përket bashkëpunimit dhe komunikimit në relacionin Komisioni – Ministria për Komunitete dhe Kthim, Qeverisë dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim - kuvendeve komunale. Mënyra e deritanishme e bashkëpunimit nuk është treguar e mirë. Në këtë kontekst bashkëpunimi duhet të jetë në vazhdimësi dhe i pa penguar në interes të përgjithshëm në fusha të ndryshme të jetës shoqërore me qëllim të vendosjes së..... për të mirën e të gjitha komuniteteve. Posaçërisht bashkëpunim i me përfaqësuesit lokal nëpër komuna është katastrofave, ku ka evidencë të manipulimit të llojeve të ndryshme sa i përket çështjeve të projekteve për ndërtim dhe kthim. Në këtë drejtim është shumë me rëndësi që për të gjitha këto Ministria ta marrë rolin së bashku me ne, me qëllim të koordinimit të programeve për të mirën dhe stabilizimin komuniteteve të mbështetura nga ICO dhe OSBE.

Gjithashtu tha se Komisioni dhe Ministra duhet që në periudhën e ardhshme të kenë bashkëpunim të ngushtë për të gjitha çështjet nga kompetencat e veta në kuptim të ndërrimit të informatave dhe mendimeve rreth problemeve në mënyrë që komuniteteve t'u ndihmohet në mënyrë adekuate dhe duhet përpjekur që në procesin e buxhetit Ministria për Komunitete dhe Kthim të ndajë mjete më të mëdha për realizimin e qëllimeve të verifikuara lidhur me komunitete.

Gjithashtu, ky komision, ka për detyrë të kontrollojë punën e Ministrisë, që do të thotë se ky komision kontrollon punën e kësaj Ministrie dhe se Komisioni nuk donë të ketë vetëm funksion kontrole, por edhe rolin e bartësit të bashkëpunimit në mënyrë që ajo që marrëveshjet të realizohen. Duhet të ketë marrëveshje konkrete lidhur me bashkëpunimin vendimmarrjen dhe pjesëmarrjen, sepse në procesin e vendimmarrjes, përfaqësues të komuniteteve nga ky komision janë larguar, në mënyrë që të gjendet mënyra e përshtatshme e bashkëpunimit në mes të Komisionit dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në mënyrë që të jenë pjesëmarrës aktiv për gjendjen në komunitetet tona. Për mua këto janë çështje të veçanta, ndërsa qëllimi i funksionit është konkret, përfundoi ai për tu kthyer në asistencën sociale nuk janë definuar kriteret që një familje duhet t'i plotësojë në përputhje me kushtet e përcaktuara. Janë evidente manipulimet nëpër komuna, në zyret e departmaneve dhe për këto parregullësi ata janë përgjegjës e jo

Ministria. Duhet të identifikohen dhe të merren masa dhe të tregohet përkushtim që të mënjanojnë këto keqpërdorime sepse këto ndikojnë shumë në jetën e bashkësive.

Sadik Idrizi tha se ka shumë probleme edhe në nivelin lokal edhe atë qendror lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me bashkësitë. Në nivelin lokal ekzistojnë tri institucione që merren me çështje të bashkësive dhe këto janë zyret për bashkësi, komitetet komunale dhe zyret për kthim. Kurse në nivelin qendror ekziston Zyre e komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, pastaj Ministria për komunitete dhe për kthim, Komisioni parlamentar për komunitete dhe Këshilli konsultativ për komunitete. Kur kemi të bëjmë me projektet, prioritet duhet dhënë projekteve kolektive dhe jo projekteve individuale dhe spontane. Lidhur me bashkëpunimin në këtë drejtim duhet organizuar na bashkëpunim me MKK në ndonjë nivel tryezë të rrumbullakët ku do të identifikoheshin dhe do të shqyrtohen të gjitha problemet. Duhet vendos të gjitha format e bashkëpunimit me qëllim të zgjidhjes të problemeve të përbashkëta që do të kishte si rezultat suksesin në punën e përgjithshme të ministrive dhe komisioneve.

E konsideroj si shumë të rëndësishme që disa probleme duhet zgjidhur bashkërisht dhe që përgjegjësia të ndahet.

Zylfi Mexha tha se tash për tash një prej problemeve më aktuale dhe njësoj i prek të gjitha bashkësitë, është sigurisht kthimi i njerëzve na vendet e Evropës Perëndimore. Kur është fjala për funksionimin e zareve të bashkësive kemi një situatë jo të kënaqshme dhe kemi probleme evidente në terren si dhe probleme lidhur me ndarjen adekuate të mjeteve buxhetore. Duhet forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin në të gjitha nivelet me përfaqësuesit lokal dhe qendror dhe në këtë plan duhet të bëjmë më shumë punë.

Rexhep Hoti u lidh me diskutimet e diskutuesve të tjerë dhe tha se problemi më i madh është në nivelin lokal ku janë të theksuara keqpërdorimet në menaxhim si dhe korrupsioni, por për luftimin dhe evitimin e këtyre dukurive ekzistojnë mekanizma. Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Pushtetit Lokal dhe komisioni në këtë drejtim, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe jo qeveritare mund të formojnë komision hulumtues ad-hoc që, së bashku me përfaqësuesit e komuniteteve dhe kryetarin e komunës do të bënin kontrollin lidhur me shkallën e zbatimit dhe respektimit të segmenteve ndihmës për bashkësitë, të vlerësojnë shkallën e zbatimit dhe për rastet konkrete të propozojnë masat.

Me qëllim të hulumtimit të problemit, të shkaqeve dhe të pengesave të cilat duhet zgjidhur dhe tejkaluar lidhur me bashkësitë, komisioni ynë duhet të fillojë iniciativën që të vizitojë vendet e Evropës, për shembull të vizitohet Brukseli prej nga mund të ketë zhvillim të dhunshëm të pjesëtarëve të bashkësive. Me këtë rast duhet bërë përpjekje që të formohet një fond për ndihmë bashkësive me mbështetje të organizatave ndërkombëtare dhe të qeverive të vendeve Perëndimore të cilat në mënyrë të qartë dhe transparente do të ndanin para për këtë destinim për një strategji të organizuar, të kuptueshme dhe këmbëngulëse që së pari nënkupton përkujdesjen ndaj atyre që janë kthyer dhe krijimin e kushteve për jetë.

Komentet dhe përgjigjet e Ministrit lidhur me pyetjet dhe sugjerimet e paraqitura

Jam për vendosjen e të gjitha formave të bashkëpunimit në favor të një koordinimi cilësor me qëllim të zgjidhjes së problemeve të përbashkëta që do të kishte një rezultat të suksesshëm në punën e përgjithshme të ministrisë dhe të komisionit.

Sa i përket panit dhe strukturës së shfrytëzuesve të asistencës sociale dhe të numrit të bartësve të skemës sociale të ndihmës familjeve më të rrezikuara të Ashkalinjve, me marrëveshje nga viti i kaluar, që është nënshkruar nga Zyra e Kryeministrit, MKK dhe Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, është siguruar buxhet i mjaftueshëm për këtë destinim. Arsyet e para të vonësës së zbatimit të këtij programi janë regjistrat e pa kompletuar të shfrytëzuesve të ndihmës sociale dhe kam frikë se për këtë shkak mjetet buxhetore do të mbesin të pa shpërndara dhe të pa implementuara. Bartës të këtij projekti janë Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale dhe departamentet komunale për politikë sociale. Në momentin kur MKK do të marrë regjistrin përfundimtar, mjetet do të transferohen.

Kur është fjala për projektin e ndërtimit të 44 shtëpive në fshatin Dubravë, ka disa çështje teknike të cilat duhet zgjidhur dhe pastaj të fillojë ndërtimi dhe këto çështje janë regjistri i shfrytëzuesve, lokacioni, leja urbanistike. Nëse këto çështje nuk zgjidhen, mjetet buxhetore do të kthehen si të pashfrytëzuara dhe shfrytëzuesit do të pësojnë.

Fatkeqësisht, më duhet të them se pa decentralizimit kompetencat u barten nga niveli qendror në nivelin lokal dhe për ato kompetenca që mendohet se i ka Ministria, ajo në të vërtetë nuk i ka në asnjë sferë, kurse i ka përgjegjësitë. MKK i kryen funksionet e saj në këtë kontekst përmes UNDP-së dhe Lidhjes Daneze për Refugjatë, por këto procese në mënyrë të drejtpërdrejtë janë pak të implementuara.

Ekzistojnë probleme lidhur me keqpërdorime të caktuara në nivelin lokal, por është vështirë të identifikohen ato. Parimisht gjërat nuk duhet përgjithësuar sepse këto janë raste individuale dhe këto dukuri duhet t'i kufizojmë në minimum. Me plotësimet e Ligjit të qeverisjes lokale është arrit që të ekzistojnë zaret për kthim si dhe struktura e tyre organizative, funksionimi financiar dhe përgjegjësitë rreth bashkësive në terren. Momentalisht, MKK gjendet në fazën e riorganizimit, e cila do të ndryshojë dukshëm në kuptim të hapjes së drejtorive të reja dhe mbylljen e disave që nuk u treguan të efektshme për qëllimet që u formuan.

Komentet dhe propozimet lidhur me përfaqësimin e bashkësive në botë dhe lidhja me qeveritë amë të vendeve evropiane në raport me kthimin e dhunshëm, ka shumë probleme të theksuara me të cilat po ballafaqohemi dhe presim që këto të zgjidhen. Çështja e kthimit është çështje e ekzistencës dhe e ardhmërisë së bashkësive, kështu që besoj se do të arrijmë t'i bindim qeveritë amë të Evropës që në aspekt financiar të ndihmojnë këtë proces në mënyrë që kthimi të jetë i qëndrueshëm, kurse kthimi i dhunshëm pa siguruar kushtet ekzistenciale për jetë edhe më shumë do ta vështirësonte ekzistencën në aspektin ekonomik, social e madje edhe në aspektin e sigurisë. Është shumë e rëndësishme që në gjithë këtë Ministria të ketë një rol sa më të madh së bashku me përfaqësuesit e bashkësive, në mënyrë që sa më mirë t'i prezantojnë, shpjegojnë dhe t'i mbrojnë interesat

e bashkësive në të gjitha strukturat ndërkombëtare (në Këshillin e Evropës, në Parlamentin Evropian etj.)Kemi përkrahje financiare të bashkësisë ndërkombëtare, të Brukselit dhe të Komisionit Evropian për stabilizimin dhe forcimin e bashkësive, që menaxhohet nëpërmjet partnerëve në bashkëpunim me qeverisjen lokale.

Në domenin e legjislacionit të gjitha ligjet e aprovuara janë harmonizuar me standardet dhe në interesin tonë është që të përcjellim miratimin e ligjeve dhe ndikimin e tyre ose depërtimin në të drejtat dhe interesat e bashkësive, kurse lidhur me implementimin e tyre duhet të bëjmë përpjekje maksimale për zbatimin e tyre të plotë në praktikë, në mënyrë që shumë çështje të zgjidhen.

Në fund, MKK është e gatshme për të gjitha format e bashkëpunimit me këtë komision në krijimin e politikave dhe të qasjes ndaj bashkësive me qëllim të një opreacioanalizimi të mirë në punë për të gjitha çështjet që janë në kompetencë të saj.

Procesverbalin e hartoi:

Njësia e komisioneve parlamentare

**Zëvendja e parë e kryetarit të Komisionit,
Saniye Aliaj**